

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar kolegji, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. M. nga ..., të cilin e përfaqëson me autorizim A. V. av. nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a.në Prishtinë- Distribucioni Mitrovicë, me përfaqësuesin e autorizuar Osë Kuqi, jurist i diplomuar, sipas lëndës së kontestit kompensim i dëmit material, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr.818/2014 datë 09.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a.në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.818/2014 datë 09.07.2018

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr.818/2014 datë 09.07.2018, refuzohet si e pabazuar ankesa e të autorizuarës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a.në Prishtinë dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.14/2009 datë 18.11.2013, me të cilin është obliguar e paditura që në emër të kompensimit të dëmit për djegien e gjësendeve në shtëpinë e paditësit t`ia paguaj të njëjtit shumën prej 3.349,10 euro me kamatë sikurse për mjetet e depozituara bankare pa destinim të caktuar, të gjitha këto në afat prej 15 ditë nënë kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Është obliguar e paditura që t`ia kompensoj paditësit

shpenzimet e procedurës kontestimore dhe ate siç vijon: shumën prej 1.352 euro në emër të 10 seancave të përfaqësuara nga ana e avokatit, 104 euro në emër të taksës në padi, 100 euro në emër të dy ekspertizave, 25 euro në emër të taksës për padi si dhe gjykatës në emër të taksës për vendim shumën prej 25 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nënë kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur e paditura , për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t`a aprovoj revizionin si të themelt, aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të miratohet kërkesëpadija e paditëses në tërësi si e bazuar apo të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura me propozim që revizioni i paditëses të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi A. M. nga ..., në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me kërkesë që e njëjta të detyrohet që paditësit t`ia kompensoj dëmin material të shkaktuar me datën 02.11.2008 të shkaktuar nga rryma në një pjesë së shtëpisë së banimit e cila gjendet në ..., të në shumë prej 4.000,00 € të cilën shumë sipas ekspertizës gjyqësore e ka precizuar në shumë prej 3.349,10 euro me kamatë ligjore duke filluar nga data e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive, duke konsideruar se deri te hjo situatë ka ardhur me fajin dhe përgjegjësinë e të paditurës si furnizues me energji elektrike e për shkak të jo stabilitetit në furnizim me intensitet shumë të ndryshueshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave përfshirë këtu edhe ekspertizën e ekspertit A. N., ing. i elektros e hartuar me datë 03.06.2013, lidhur me vërtetimin e shkaktarit të djegies së shtëpisë së banimit të paditësit, të ekspertit financiar M. F. ecc. i diplomuar e hartuar me dt. 23.07.2013, e plotësuar me dt.04.09.2013, për vlerësimin e dëmit të shkaktuar në dhomën e paditësit bashku me pajisjet brenda saj, pa mëdyshje ka vërtetuar se përgjegjësia për ndodhjen e

këtij zjarri bie mbi të paditurën e që si rezultat edhe barra e kompensimit të dëmit që paditësi ka pësuar, bie në barrë të saj, prandaj e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit në shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimimit në tërësi ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë sepse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale sipas përgjegjësisë së paditurës, gjë që nuk ka mundur të vihet në dyshim me pretendimet ankimore të ndërgjygjësve dhe pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ultë drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia është e bazuar. Në aktgjykimet e cekura ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare të cilat si të drejta dhe ligjore i pranon edhe kjo gjykatë.

Thëniet e revizionit se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljeve esenciale nga neni 182 par.2 të LPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësoi si të pa bazuara, nga se në aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ultë janë dhënë arsye të ta dhe në përputhje me provat ekzistuese në lëndë, ndërsa në revizion përveç që është cekur dispozita ligjore, nuk është cekur asnjë pretendim konkret se në cilën pjesë të aktgjykimit arsyet janë të paqarta dhe kontradiktore me provat në të cilat mbështetet aktgjykimi.

Pretendimet e cekura në revizion se gjykatat e instancës më të ultë në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Gjykata Supreme i vlerësoi si të pa bazuara, nga se gjykata e shkallës së parë në bazë të ekspertizës së ekspertit të elektros ka vërtetuar përgjegjësinë e të paditurës, pasi prekja e përçuesve ka ndodhur larg shtëpisë së paditësit e që është zonë e përgjegjësisë që i takon KEK-ut, ndërsa lartësinë e dëmit, gjykata e ka vërtetuar në bazë të ekspertit financiar M. F. ecc. i dpl., i cili ka vlerësuar se dëmi për riparim dhe rindërtim llogaritet në vlerën prej 3.349,10 euro. Gjykata e instancës më të ultë në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 154 të LMD-së e cila dispozitë parasheh se kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij, ndërsa neni 158 të po të njëjtit ligj është paraparë se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia.

Gjykata Supreme e Kosovës , shqyrtoj pretendimet e cekura në revizion se e paditura nuk përmban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar, pasi që avaria ka ndodhur siç thuhet në kërkesë nga veprimet e personit të tretë – mjetit bager të drejtuar nga një person i cili nuk është identifikuar nga organet e sigurisë dhe se në ekspertizë nuk janë cekur nuk janë dhënë provat për mbështetjen e mendimit të dhënë , por të njëjtat kanë qenë objekt shqyrtimi edhe para gjykatave të instancës më të ultë, dhe kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike për të cilën konform nenit 214 par.2 të LPL-së, revizioni nuk mund të paraqitet.

Nga sa u tha më sipër me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.343/2018 datë 13.11.2018

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri